



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.

Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.

e-mail.: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)

Në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve, Ndërmarrja Publike Lokale PALLATI I RINISË SH.A., **shpallë:**

## **FTESË PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE**

Ftoheni që të ofertoni për marrje në shfrytëzim me qira lokalet afariste, zyret dhe depot të cilat janë pronë e **N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.** Pronat e evidentuara me poshtë u jepen me qira personave juridik.

### **Hapësirat afariste të cilat jepen me qira:**

| Nr. | Adresa       | Sipërfaqja        | Çmimi fillestar për m <sup>2</sup> (pa TVSH) | Nr. | Adresa     | Sipërfaqja        | Çmimi fillestar për m <sup>2</sup> (pa TVSH) |
|-----|--------------|-------------------|--|-----|------------|-------------------|--|
| 1.  | Lokali nr.50 | 22 m <sup>2</sup> | 12.00 €                                      | 8.  | Depo nr.02 | 54 m <sup>2</sup> | 6.17€  |
| 2.  | Lokali nr.52 | 42 m <sup>2</sup> | 12.00 €                                      | 9.  | Depo nr.04 | 70 m <sup>2</sup> | 6.17€  |
| 3.  | Lokali nr.58 | 96 m <sup>2</sup> | 12.00 €                                      | 10. | Depo nr.05 | 60 m <sup>2</sup> | 6.17€  |
| 4.  | Lokali nr.65 | 27 m <sup>2</sup> | 12.00 €                                      | 11. | Depo nr.06 | 70 m <sup>2</sup> | 6.17€  |
| 5.  | Lokali nr.67 | 12 m <sup>2</sup> | 12.00 €                                      | 12. | Depo nr.07 | 70 m <sup>2</sup> | 6.17€  |
| 6.  | Lokali nr.68 | 23 m <sup>2</sup> | 12.00 €                                      | 13. | Depo nr.08 | 60 m <sup>2</sup> | 6.17€  |
| 7.  | Lokali nr.71 | 6 m <sup>2</sup>  | 12.00 €                                      | 14. | Zyre 116/3 | 60 m <sup>2</sup> | 5.00€  |

### **Kushtet e Përgjithshme**

1. Periudha e qiradhënies është për 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi.
2. Qiramarrësi me anë të nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shumë monetare në vlerë të një qiraje mujore në llogari të Qiradhënësit.
3. Qiramarrësi është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës të bëjë sigurimin e mallit nga kompanitë e sigurimit.
4. Përveç çmimit fillestar, qiramarrësi do të paguaj plus shpenzimet tjera të parashikuara me kontratë (rrymë, pastrim, nxehe, ujë, kanalizim), plus TVSH.

### **Kriter për përzgjedhjen e ofertuesit me të favorshëm është:**

1. Çmimi me i lartë i ofertuar se sa çmimi fillestar.
2. Tarifa e aplikimit është 200.00 €, ku ofertuesit të zgjedhur, tarifa e aplikimit do t'i kompensohet me faturën e parë të qirasë, ndërsa ofertuesit të zgjedhur i cili tërhiqet nga Kontrata për qira, nuk i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 €, dhe ofertuesit të pazgjedhur i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 €, e cila do të paguhet në këtë Kont: **1708020600000056**.

### **Ofertuesi duhet t'i dorëzoi këto dokumente:**

1. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal (kopje)
2. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit; (kopje)
3. Çmimin e ofertuar për m<sup>2</sup> i cili duhet të jetë pa TVSH (Ofertë)
4. Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmohet se biznesi është aktiv;
5. Fletëpagesën për aplikim.

### **Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:**

1. Ofertuesi i cili ka pasur lokal me qira në Pallatin e Rinisë dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
2. Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Nëse Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuar në shpallje.

Personat juridik të cilët duan t'i vizitojnë lokalet, zyrat si dhe depot e lartcekura, mund t'a bëjnë, nga data: **14.02.2020**, deri me datën: **20.02.2020** nga ora **10<sup>00</sup>** deri në ora **15<sup>00</sup>**.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datën: **21.02.2020** nga ora **10<sup>00</sup>** deri në orën **12<sup>00</sup>**, në zyrën e arshivës së qiradhënësit **N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.** Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr i lokalit, zyrës ose depos dhe kontaktet, si: email-i zyrtar, dhe/apo nr. i telefonit .

Ofertat do të hapen nga ana e komisionit, me datë: **21.02.2020**, nga ora: **12:30**, në prezencën e ofertuesve, në zyrën e Drejtorisë së Pallatit të Rinisë në Prishtinë.

Kërkesa (aplikacioni) mund të kërkohej përmes email-it: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com), në formë fizike në zyrën nr. 17, apo të shkarkohet nga faqja zyrtare e "Pallatit të Rinisë": <http://www.pallatirinise.com/>.